

RAPORTI
PARAPRAK
I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Shtojca II Pika 10 Germa b

TE AKTIVITETIT:

PËR RIKONSTRUKSIONI I
ARGJINATURËS PËR
MBROJTJEN NGA LUMI
VJOSA, ZONA Krahu u
mahtë I degës Martinës
Ferrasil L-1448 ml

Investitori BASHKIA FIER

Pergatiti:
Gjeo ambientalist
Ing. Aleksander Rukaj



PERMBAJTJA

HYRJE

- Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se
- Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional
- Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit Paraprak te VNM-se
 - a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.
 - b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqene kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.
 - c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.
 - ç) Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.
 - d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.
 - dh) Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.
 - e) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.
 - ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.
 - ñ) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).

HYRJE

Hyrje

Lumi Vjosa është një ndër lumenjte më të mëdhenj të Shqipërisë dhe më i madh që kalon nëpër Myzeqe dhe nëpër qarkun e Fierit. Ky lum herë pas here ndodhinn përmbytjet e theksuar kjo mbas viteve 90 përmbytja ndodh duke kaluar argjinaturat dhe bënë përmbytje në të dy anët ne tij,por dëmet më të mëdha i bënë në zonën e Bashkisë Fier.

Në pjesën fushore Vjosa nuk ka argjinatura të mirëfillta por argjinatura e kanaleve ujitës nga ana e lumit është zgjeruar dhe është shfrytëzuar për argjinaturë.

Përmbytjet janë bërë shumë të shpeshta sidomos që kur është ndërtuar kalimi i autostradës Levan-Vlorë,sa ato janë aqë të shpeshta sa kanë ndodhur dhe dy herë brënda një viti.

Përmbytjeve u nënshtrohen rreth 17 000 ha vetëm në Bashkinë Fier Ujujrat e lumit Vjosa kalojnë argjinaturën e kanalit të Martinës dhe ndjekin , kryesisht kanalin e Depresionit, që mendohet se në lashtësi ka kaluar lumi Vjosa dhe mbyt të tërë hapsirën midis lumit Vjosa dhe Kolektorit Rroskovec-Hoxharë.Përmbytje bëhen edhe duke kaluar argjinaturat pas urave të mifolit e të autostradës.

Vetëm për periudhën që kur është ndërtuar kalimi i autostradës Levan-Vlorë mbi lumin Vjosa, dëmet nga përmbytja vlerësohen në mbi 100 milion Euro.

Duke patur parasysh dëmet aqë të mëdha , si dhe rëndësinë e madhe ekonomike të zonës, kërkohet ti jepet fund fenomenit të përmbytjeve, duke trajtuar argjinaturat si të klasit të parë,ashtu siç i kanë lumenjt e tjerë, me prurje kontrolli 1 herë në 100 vjet (1% siguri).Sipas normativave këto argjinatura mbrojnë sipërfaqe më të mëdha se 10 000 ha dhe u takon që të korigjohen pë siguritë që i takojnë.

Me këtë rast korigjohet edhe pasaktësia e trajtimit të kalimit të autostradës mbi lumin Vjosa.Ura e autostradës është gati dy herë më e shkurtër se gjatësia e urës hekurudhore. Shtojmë se pjesa tjetër e autostradës nga lumi deri tek kanali U1 është trajtuar me mbushje në vend që të trajtohej me urë.

Në kryqëzimet e argjinaturës me hekurudhën dhe autostradën të sigurohet vazhdimësia e argjinaturës dhe e rrugës mbi të.Argjinaturat btë bëhen 3,5 m të gjëra dhe të veshura me një shtresë 20-25 cm zhavor të ngjeshur. Atje ku ka mundësi,argjinaturat ekzistuese (argjinaturat e kanaleve ujitës të Martinës dhe U1 nga ana e Vlorës) të spostohen në drejtim të lumit ,për të mbrojtur më tepër toka nga përmbytjet.

Të mendohet një zgjidhje që zona nga përroi i Klosës e në drejtim të Jugut ,midis kanalit Vjosë-Levan-Fier-Libofshë dhe kanalit të Martinës të mos përmbytet nga vërshimet e lumit Vjosa.

Edhe kalimi i anëkalimi (Byass) Fier-Levan mbi lumin Seman reflekton të njëjtin gabim si kalim i mbi Vjosë të autostradës Levan-Vlorë.

Gjatë zgjidhjeve , mundësisht që kalimi i autostradës Levan-Vlorë mbi lumin Vjosa të ngelet ashtu siç është ndërtuar.

Studimi duhet të ketë parasysh mbrojtjen e kanalit Vjosë-Levan-Fier-Libofshë gjithashtu edhe një parashikim të mbrojtjet gërryerjet e brigjeve të Vjosës për të dy bashkitë Fier e Vlorë.

Në Kalivaç e Poçem po bëhen projekte për të marrë me konçesion dy hidrocentralet .Të studiohet se çfarë ndryshimesh mund të bëhen tek ata(për shkarkimet e prurjeve maksimale) që të bëhet e mundur mbrojtja nga përmytjet e lumit Vjosa në pjesën e poshtëme të saj e sidomos pas veprës së marrjes së kanalit Vjosë -Levan-Fier-Libofshë. Me këtë detyrë projektimi mbështesim zyrtarisht inisiativën për studimin e plotë të mbrojtjes nga përmytjet nga lumi Vjosa.Bashkia ve në dispozicion harta digitale,batimetrinë e lumit Vjosa bashkë me batimetrinë e grykderdhjes së saj në det,projektet ekzistuese të objekteve që ndihmojnë për studimin e projektimin e kësaj vepre.

Kapitulli 1 QELLIMI I HARTIMIT TE RAPORTIT VNM DHE BAZA LIGJORE

➤ Qellimi i hartimit te raportit te VNM

- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis te projektit te propozuar u realizua per te vleresuar ndikimet e mundshme negative te zbatimit te tij ne vlerat natyrore te zones ku do te zbatohet si dhe performancen mjedisore te tij. Ne thelb te vleresimit mjedisor te projektit qendron evidentimi i pikeprerjeve te tij me legjislacionin ne fuqi, vlerave natyrore qe gjenden ne zonen e projektit dhe si e sa do te ndikohen ne rast te zbatimit te tij. Njekohesisht Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis evidenton dhe propozon masat qe duhen materializuar nga zbatuesi i projektit ne te gjithë fazat e zhvillimit te tij per te mbrojtur cilesite mjedisore te zones dhe vlerat natyrore te saj dhe per te rritur performancen mjedisore .
- Hartimi i Raportit do te konsistoje ne :
- Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit te tij;
- Mbledhja e informacioneve dhe te dhenave mbi vlerat natyrore te zones dhe planet e zhvillimit te saj;
- Me marjen e lejes zhvellimore dhe fillimin e punimeve Bashkia Fier do ti beje prezentjet subjekti ndertues, azhornimin me infrastrukturen ekzistuese . Ne kete azhornim do te paraqese te gjitha linjat egzistuese te telefonise, rrjeti elektrik, ujesjelles kanalizime, furnizimin me uje dhe lidhjen me rjetin rrugor .

- Realizimi i rikoniucionit ne terren per verifikimin e informacionit te grumbulluar dhe vleresimin e gjendjes ne vend;
- Analiza e informacionit dhe perzgjedhja e ceshtjeve te rendesishme;
- Hartimi i raportit mjedisor te projektit ndertimor .
- Raporti i VNM permbledh nje pershkrim te projektit te propozuar, si per fazen ndertimore dhe per ate te shfrytezimit ky raport do te jaspri ne detaje pershkrimin e karakteristikave te mjedisit prites ekzistues, analizen e ndikimeve te mundshme ne mjedis te projektit te propozuar, planin e masave per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve te mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

➤ **Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional**

- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 " **Per Mbrojtjen e Mjedisit**"
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « **Per Lejet e Mjedisit** »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « **Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis** »
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 "**Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes**".
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 "**Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara**"
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 "**Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta**"
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 "**Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja**"
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 "**Per menaxhimin e integruar te mbetjeve**"
- Vendim nr.805 date 4.12.2003 « **Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore** »
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « **Per largimin publik te mbeturinave** »
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « **Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis** »
- Udhezim per dokumentacionin e duhur per "**Leje Mjedisore**"
- Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014 "**Për Lejet Mjedisore**"

- Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së"
- VKM nr. 686 datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".
- Ligji 12.2015 date 26.02.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011" Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".

➤ ***Procedura e miratimit mjedisor te projektit***

Projektet me ndikim ne mjedis duhet te ndjekin proceduren e vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe te miratohen perpara fillimit te zbatimit te tyre ne terren. Bazuar ne dispozitat e Ligji t nr.10440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", veprimtaria e propozuar duhet t'i nenshtrohet procedures se Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis (Shtojca 2, pika 10/b - "Projekte per zhvillime urbane.....").

➤ **PROFILI I PROPOZUESIT**

Lumi Vjosa është lumi i dytë më i madh në vendin tonë. Ai është i gjatë 281 km, me sipërfaqe ujëmbledhëse prej 6710 km² nga të cilat 4655 km² janë brenda territorit të Shqipërisë kurse pjesa tjetër prej 2085 km² ,fillimi, është në territorin grek. Për potencialin e saj hidrik lumi Vjosa ka tërhequr vëmendjen dhe për shfrytëzimin e këtij potenciali janë bërë studime të ndryshme. Më i madhi nga këto studime komplekse është ai i kryer nga ish instituti i Studimit dhe i Projektimit të Hidrocentraleve , të përfunduar më 1989, në bashkëpunim edhe me si ish Institutin e Studimeve dhe Projekttimeve të Veprave Ujore të Bujqësisë , ish Institutit Hidrometeorologjik dhe të gjithë institucioneve të tjera të lidhura me këto probleme si dhe pushtetit vendor të asaj kohe.

Në kohët para vitit 1990, nga energjika , është kërkuar që të ndërtohen hidrocentrale mbi lumin Vjosa në mënyrë që të bëhej një balancim më i mirë i prodhimit të energjisë elektrike . Kjo nuk është realizuar dhe ne kemi një përqëndrim të prodhimit të energjisë elektrike në veri dhe linja të gjata transmetimi për në jug që është e shoqëruar me problemet veta të njohura.

Në lumin Vjosa deri tani janë bërë tentativa për të ndërtuar hidrocentralin e Kalivaçit dhe të Poçemit.

Sipas studimit të mësipërmë, këta dy hidrocentrale kanë në dorë edhe zgjidhjen përfundimtare të kërkesave për ujë për bujqësinë në zonën kodrinore të Bashkive , Fier, Mallakastër dhe Vlorë. Ky problem nuk ngacmohet fare në projektkonçesionet.

Një pasurisë ujore të lumit Vjosa është shfrytëzuar për ujitjen e tokave biqësore dhe ndërtimet më të mëdha për këtë qëllim janë kryer për pjesën fushore dhe pjesërisht për kodrinore. Vepra më madhore është Kanali Vosë-Levan-Fier i ndërtuar në vitin 1955 dhe më vonë ,me rikonstruksionin e tij për rreth 30 m³/s u zgjat deri në zonën e Libofshës dhe mori emrin Kanali ujitës Vjosë-Levan-Fier-Libofshë.

Hapsira Fier-Lushnjë ka patur investime shumë të mëdha në drejtim të kullimit, ujitjes dhe mbrojtjes nga për mbytjet e lumenjëve Seman, Shkumbin dhe Vjosë dhe pothuajse janë projektuar e ndërtuar njëkohësisht edhe zonat e tjera të ultësirës bregdetare perëndimore të Shqipërisë.

Vendndodhja e Zones se Projektit

Projekti Ideja Mbrojtja nga përmbytjet e Lumit Vjosa



PARAMETRA TEKNIKE

Lumi Vjosa me sipërfaqe të përgjithshme të pellgut ujëmbledhës prej 6710 km² dhe gjatësi 272 km, është lumi më i madh në Shqipërinë e Jugut dhe nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit. Rreth 30% e sipërfaqes ujëmbledhëse (2085 km²) të lumit Vjosë ndodhet në Greqi. Kur hyn në vendin tone Vjosa e ka marrë formën e një lumi të konsiderueshëm me një prurje prej rreth 57 m³/s. Pikërisht në pikën e hyrjes në Shqipëri kemi bashkimin e Vjosës me degën e saj më të madhe në Greqi, Sarantaporos.

Në Vjosë, në territorin shqiptar, derdhen degë të shumta. Përveç dy degëve kryesore, Drinos dhe Shushica, që në fakt për nga madhësia e pellgut ujëmbledhës si edhe nga sasia e ujit që transportojnë janë lumenj më vete, ka dhe një sërë përrenjsh me sipërfaqe deri 300 km² që derdhen në trungun e Vjosës. Kështu që nga hyrja në territorin shqiptar deri në Dragot, në Vjosë derdhen përrenjtë e Çarshovës (90.8 km²), Langaricës (337 km²), Lemnicës (103 km²), Dishnicës (173 km²) nga ana e djathtë si edhe përroi i Zagorisë (171.6 km²) në krahun e majtë. Në Tepelenë kemi bashkimin e Vjosës me lumin Drinos dhe mbas Tepelenës derdhet përroi i bukur i Bënçës (174.6 km²)

Hidrologjia e lumit Vjosë

1. Rrjedhja ujore vjetore

Analiza e të dhënave

Në pellgun e lumit Vjosë kanë funksionuar disa vendmatje hidrometrike gjatë periudhës 1948 deri në vitin 2000. Duke qenë se një pjesë e tyre nuk i kanë plotësuar kushtet e përshtatshme për vlerësimin e rrjedhjes ujore ato janë mbyllur me kalimin e kohës dhe janë hapur të reja. Në tabelën e mëposhtme jepen vendmatjet kryesore dhe periudhat e funksionimit të tyre duke u përqendruar në pjesën që i intereson këtij studimi.

Nr.	Vendmatja	Sipërfaqja ujëmbledhëse, km ²	Periudha funksionimit
1	Vjosa Çarshovë	2180	1977- vazhdon
2	Vjosa Përmet	2820	1968 - vazhdon
3	Drinos Ura Leklit	1300	1948 – vazhdon
4	Vjosa Dorzë	5420	1958 - 1990
5	Vjosa Poçem	5570	1968 – vazhdon
6	Vjosa Mifol	6680	1948 - vazhdon

Ashtu si u tha me sipër, rrjedhja ujore (prurja) mesatare shumëvjeçare është llogaritur për periudhën 1948-2000. Rezultatet e përfuara nga llogaritjet përkatëse për të gjithë akset e marra në konsideratë jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelën 2.

Tab. 2 Prurjet mesatare vjetore shumëvjeçare të Vjosës

Nr.	Vendmatja	F km ²	Q m ³ /s	q l/s/km ²
1	Vjosa Çarshovë	2180	56.7	26.0
2	Vjosa Përmet	2820	66.5	23.6
3	Drinos Ura e Leklit	1300	36.6	28.2
4	Vjosa Dorzë	5420	145.7	26.9
5	Vjosa Poçem	5570	150	26.9
6	Vjosa Mifol	6680	180	26.9

2. Rrjedhja maksimale

Plotat maksimale në lumin Vjosë shkaktohen kryesisht nga shirat, të cilët siç dihet bien më shumë në periudhën Nëntor-Mars. Reshjet në formë bore ndikojnë pak në formimin e plotave maksimale. Nga analiza që i është bërë hidrogramave të plotave më të mëdha të vrojtuar në trungun e Vjosës rezulton se në shumicën e rasteve ato janë njëkulmëshe. Megjithatë ka raste kur ato janë dykulmëshe dhe për rrjedhojë kanë volum më të madh se ato njëkulmëshe.

Për llogaritjen e prurjeve maksimale me siguri të ndryshme janë përdorur dy metoda: metoda statistike dhe metoda Gradex. Metoda statistike është metoda me klasike e llogaritjes së prurjeve maksimale dhe që konsiston në përshtatjen e serisë së vrojtuar të prurjeve maksimale me një shpërndarje teorike probabilitetike me anë të së cilës bëhet ekstrapolimi i prurjeve maksimale për sigurinë e kërkuar.

Nga llogaritjet e bëra nga sa u tha me sipër rezultuan prurjet maksimale si me poshtë:

Prurjet maksimale me siguri të ndryshme (Metoda statistike)

Vendmatja	S km ²	Probabiliteti					
		0.9999 10000 vjet	0.999 1000 vjet	0.99 100 vjet	0.98 50 vjet	0.95 20 vjet	0.90 10 vjet
Vjosa Përmet	2820	3630	2960	2820	2140	1960	1560
Vjosa Dragot	3470	4620	3590	3470	2560	2240	1840
Drinos Ura Leklit	1300	2835	2235	1300	1630	1440	1130
Dorzë	5420	7760	6210	4660	4200	3570	3090

Poçem	5570	7920	6330	4740	4260	3610	3120
Ura Mifolit	6680	9350	7640	5870	5310	4570	3960

3. Rreth problemit të përmytjeve në lumin Vjosë

Shqipëria karakterizohet si një vend që preket në mënyrë të shpeshtë nga fenomeni i përmytjeve. Kryesisht lumenjtë që kanë shkaktuar deri më sot përmytje të përmasave të konsiderueshme janë lumenjtë Drini-Buna dhe Vjosa. Para pak vitesh vëmendja ishte përqendruar në veri në zonën e Drinit dhe Bunës ku përmytjet janë të një karakteri të përzierë ku përveç faktorëve natyrorë ndikim ka dhe aktiviteti njerëzor nëpërmjet administrimit të kaskadës hidroenergjetike mbi lumin Drin.

Megjithëse intensiteti dhe shpeshtësia e përmytjeve do të rritet nga shpyllëzimet pa kriter, përmytjet në Shqipëri mund të karakterizohen kryesisht si fenomen natyror dhe që lidhet më tepër me kushtet mbizotëruese gjeomorfologjike dhe klimatike. Në këto kushte zgjidhja e problemit duhet të kërkohet më tepër në masat për zbutjen e efekteve të përmytjeve, të tilla si rritja e magazinimit të ujit nëpërmjet ndërtimit të rezervuarëve dhe mbrojtjen e tokave të ulëta me anë të argjinaturave dhe zgjidhjeve të ndryshme hidroteknike.

Fenomeni i përmytjeve po kthehet në një problem shumë shqetësues në dhjetëvjeçarën e fundit në vendin tonë. Ngjarjet e fundit të ndodhura në lumin Vjosë ka sjellë në vëmendje faktin që problemet e përballimit të fenomeneve të përmytjeve duhen trajtuar në mënyrë serioze dhe trajtimi i tyre duhet parë në aspektin integral ose siç njihet në terminologjinë përkatëse "menaxhimi integral i basenit lumor".

Fenomeni i ngjarjeve ekstreme në lumin Vjosë është një ngjarje që ndodh shpesh, por ato që mbahen mend dhe që në një fare mase kanë shkaktuar dëme ekonomike përmenden ngjarjet e dimrit 1962-1963, nata e ndërrimit të viteve 1970-1971, dhjetor 2005, 2010, 2015, 2017 dhe së fundi 2018. Ka pak informacion shkencor për këto përmytje, sidomos pas vitit 2008. Institucioni që monitoron lumenjtë e Shqipërisë, ish Instituti Hidrometeorologjik – sot IGJEUM, e ka pothuaj të pamundur të zhvillojë aktivitetin normal, për shkak të degradimit që ka pësuar në të gjitha aspektet.

Nga këto ngjarje ajo e 1 shkurtit 2015 ka thyer rekordin historik në lumin Vjosë. Përpara ngjarjes së këtij viti ngjarja me ekstreme përse i përket parametrave hidrologjike janë ato të vitit 1970-71, por ngjarjet e vitit 1962-63 kanë pasur kohëzgjatje më të madhe

dhe shtrirja e përmytjes ka qenë gjithashtu më e madhe (ndikimi në pothuaj gjithë lumenjtë e Shqipërisë). Mbas ngjarjeve të 62-63 u morren masa në rrethin lumor të vendit, edhe në Vjosë, për ndërtimin e argjinaturave për mbrojtjen nga përmytjet.

Rekordet e niveleve maksimale për Vjosën përpara kësaj ngjarje i përkisnin vitit 1970-1971, ndërsa për degën më të madhe të saj, lumin Drino, ky rekord i takon 16 Nëntorit të vitit 1962. Nga të dhënat paraprake që i referoheshin burimeve të ndryshme zyrtare rezultoi se sipërfaqja e përmytur në ngjarjen e 1 Shkurtit 2015 arriti vlerën 17000 hektarë.

Nga një analizë statistikore që u bë për nivelet maksimale në Vjosë duke marrë në konsideratë treguesit e niveleve nga gjurmët e gjetura në terren, është arritur në konkluzionin se ngjarja e vitit 1970-1971 i takon një periudhe përsëritje 1 herë në 50 vjet. Ngjarja e 1 shkurtit të vitit 2015 që mban rekordin në lumin Vjosë konsiderohet si ngjarje me periudhe përsëritje 1 herë në 75 vjet. Vëmë në dukje se edhe ngjarja e vitit 2018 (4 shkurt) ka qenë pothuaj e rendit të 2015 por për fat të keq ngjarja ka ndodhur gjatë natës dhe për pasojë nuk ka qenë e mundur të identifikohet qofte edhe me mjete të thjeshta. Do të ishte mirë që sistemi i monitorimit të lumit Vjosë të funksiononte rregullisht dhe të vjen keq që pajisjet e instaluar në lumin Vjosë, në kuadrin e projektit të emergjencave të Bankës Botërore (përfunduar në vitin 2013) nuk ishin në gjendje të regjistronin këtë ngjarje ekstreme (sistemi është prej kohësh jashtë funksionimit).

Në fenomenet e përmytjeve që po ndodhin në lumin Vjosë dihet që përveç fenomeneve natyrore një rol negativ luan edhe aktiviteti njerëzor. Në formë të përmbledhur ndikimi i aktivitetit njerëzor shprehet si më poshtë:

- Mosmirëmbajtja e sistemit të argjinaturave të Vjosës – ka mbi 25 vjet që nuk merret asnjë masë.
- Urbanizimi pa leje dhe pa kriter i tokave bujqësore
- Ndërtimi me probleme i dy autostradave Levan - Vlorë dhe Levan - Tepelenë.

Ka lindur nevoja rivlerësimit të ngjarjeve ekstreme në lumin Vjosë. Fenomenet e ndodhura në këtë dhjetëvjeçarin e fundit pa dyshim që kanë krijuar shenjat e rinj.

Pavarësisht boshllëqeve në informacionin hidrologjik duhet punuar në këtë drejtim në mënyrë që të hapet rruga inxhinierëve projektues që do të punojnë për mbrojtjen nga përmytjet e lumit Vjosë.

Lumi Vjosa është lumi më i madh që kalon nëpër Myzeqe dhe nëpër qarkun e Fierit. Pavarësisht punimeve të mëdha të kryera në të kaluarën ai herë pas here ,ai kalon

argjinaturat dhe bënë përmbytje në të dy anët ne tij, por dëmet më të mëdha i bënë në zonën e Bashkisë Fier.

Në pjesën fushore Vjosa nuk ka argjinatura të mirëfillta por argjinatura e kanaleve ujitës nga ana e lumit është zgjeruar dhe është shfrytëzuar për argjinaturë.

Përmbytjet janë bërë shumë të shpeshta sidomos që kur është ndërtuar kalimi i autostradës Levan-Vlorë. Ato janë aqë të shpeshta sa kanë ndodhur dhe dy herë brënda një viti.

Nga përllogaritjet përmbytjeve u nënshtrohen rreth 17 000 ha vetëm në teritorin e Bashkisë Fier. Në zonën e Fierit ujrati e lumit Vjosa kalojnë argjinaturën e kanalit të Martinës dhe ndjekin kryesisht kanalën e Depresionit, që mendohet se në lashtësi ka kaluar lumi Vjosa dhe mbytyt të tërë hapsirën midis lumit Vjosa dhe Kolektorit Rroskovec-Hoxharë. Përmbytje bëhen edhe duke kaluar argjinaturat pas urave të mifolit e të autostradës.

Vetëm për periudhën që kur është ndërtuar kalimi i autostradës Levan-Vlorë mbi lumin Vjosa, dëmet nga përmbytja vlerësohen në mbi 100 milion Euro.

Duke patur parasysh dëmet aqë të mëdha, shqetësimet e shpeshta që sjellin përmbytjet në qytetarët, si dhe rëndësinë e madhe ekonomike të zonës, kërkohet t'i jepet fund fenomenit të përmbytjeve, duke trajtuar argjinaturat si të klasit të parë, ashtu siç i kanë lumenjt e tjerë, me prurje kontrolli 1 herë në 100 vjet (1% siguri). Sipas normativave këto argjinatura mbrojnë sipërfaqe më të mëdha se 10 000 ha dhe u takon që të korigjohen për sigurinë që i takojnë. Me këtë rast korigjohet edhe pasaktësia e trajtimit të kalimit të autostradës mbi lumin Vjosa.

Ura e autostradës është gati dy herë më e shkurtër se gjatësia e urës hekurudhore.

Një pasurisë ujore të lumit Vjosa është shfrytëzuar për ujitjen e tokave biqësore dhe ndërtimet më të mëdha për këtë qëllim janë kryer për pjesën fushore dhe pjesërisht për kodrinore. Vepra më madhore është Kanali Vosë-Levan-Fier i ndërtuar në vitin 1955 dhe më vonë, me rikonstrukcionin e tij për rreth 30 m³/s u zgjat deri në zonën e Libofshës dhe mori emrin Kanali ujitës Vjosë-Levan-Fier-Libofshë.

Në kohën kur janë projektuar argjinaturat është vënë re fenomeni se prurjet më të mëdha të lumit Vjosa kanë qënë më të ulta se ato të lumenjëve të tjerë në veri të saj. Për këtë arsye nuk u projektuan dhe as u ndërtuan vepra me emrin argjinatura. Rolin e argjinaturave në mbrojtjen nga përmbytjet e lumit Vjosa e muarën argjinaturave të kanaleve ujitës, kjo lloj mbrojtje funksionoi mirë deri më 31 Dhjetor 1970-01 Janar 1971. Në atë kohë uji i lumit Vjosa, në anën e Fierit, ka dalë në zonën nga kolektori i Cakranit deri kulluesi K-VIII afër kthesës së kanalit ujitës të Martinës, pas marrjes nga kanali Vjosë-Levan-Fier. Pastaj që nga kilometri i parë i kanalit ujitës të Martinës që vlen edhe si argjinaturë, lumi e ka kapërcyer këtë kanal pothuajse në të gjithë gjatësinë deri në zonën Qarr-Bishan, të cilat të tëra përfunduan në hidrovorin e Hoxharës (Povelçës). Kurse në anën e Vlorës ka dalë në zonën nga Bishani-Poro- Dëllinjë. Në kohën e këtyre përmbytjeve në Hoxharë ka patur vetëm një hidrovor me prurje rreth

30 m³/s dhe në zonën e Vlorës ka qënë hidrovari në fund argjinaturës së Gjollit të Nartës ,ku bashkohet ajo me dunat e detit Adriatik.Në këtë kohë,uji i Vjosës i shkarkuar në anën e Fierit u grumbulluar në pjesën më të ulët para hidrovarit të hoxharës duke krijuar një liqen me sipërfaqe rreth 740 ha dhe ujit ka qëndruar nga 3 - 10 ditë. Dhe zona ka ngelur e përmbytur për një periudhë 1(një) muajore. Në vitin 1971 në zonën e Fieri janë përmbytur rreth rreth 9000 ha ndërsa në zonën e V.lorës rreth 3000 ha tokë.

Megjithatë ngjarjet kanë rrjedhur në dëm ekonomisë .Përmbytjet janë bërë me frekuencë pothuaj çdo vit pas ndërtimit të kalimit të rrugës së re Levan-Vlorë mbi lumin Vjosa.Kalimi i lumit Vjosa është bërë pa respektuar rregullat teknike bazë:Nuk duhet të ndryshohet gjëndja ekzistuese e lëvizjes së ujit të lumit Vjosa.Duke qënë se aty janë gjëndje argjinaturat për mbrojtje nga përmbytjet,në asnjë mënyrë nuk duhej zvogëluar kjo hapsirë me ndërtimin e urës.Fillimisht ura duhej të trajtohej e gjatë aqë sa është largësia ndërmjet argjinaturave.Ura e ndërtuar ka gjatësi 130 m,pothuajse sa është gjërësia e shtratit të lumit Vjosa.Çfardo lloj arësyesh që mund të nxirren për të justifikuar këtë projekt janë thjesht justifikime për të përligjur gabimin e bërë.Dëmi nga përmbytjet e viteve të fundit,vetëm për zonën e Fierit i kalojnë të 100 milion Euro.

Duke parë ecurinë dhe shpeshtimin e përmbytjeve nga lumi Vjosa,me iniciativën specialistëve të konfirmuar të kësaj fushe dhe që janë nga treva e Myzeqesë ,Bashkia Fier mbështeti iniciativën.

Për të realizuar studim projektimin e mbrojtjes nga përmbytjet e lumit Vjosa Studimi dhe projektimi do të syonte që argjinaturat e lumit Vjosa,me këtë rast,të vijnë në standartin që janë argjinaturat e lumenjëve të tjerë të Shqipërisë.

Për këtë U ngrit Grupi I Projektimit Drejtuar nga Ing . Hidroteknik Kristo Goga dhe Studio me projektimit ASH Engennering dhe Hartuan project idene për mbrojtjen e Lumit Vjosa ng Përmbytjet preojekt ky qe u realizuar në Vitin 2018 .

Projket ideja parashikonte ngritjen e argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimin e argjionaturave të reja dhe urën e autostradës ,përfshirë edhe urat e tjera janë llogaritur sipas standartit si argjinatura të klasit I me prurjen llogaritëse me 3% (1 herë në 33 vjet) dhe kontrolluese me 1% siguri (1 herë në 100 vjet).Sigurisht që kjo kërkon ngritje të madhe të argjinaturave ekzistuese. Sipas llogaritjeve paraprake orientuese për prurjen 5200 m³/s, niveli i ujit në aksin e kalimit mbi lumin Vjosa të autostradës do të jetë rreth kuotës 7.40 m. Kjo do të kërkonte shtimin e një ure të re me gjatësi 130 m, sa ajo ekzistuese, gërmimin e një shtrati shtesë nën urë deri në thellësinë -8.00 m si dhe ngritjen e urave me 3.50 m.Edhe urat e tjera ekzistuese e hekurudhës dhe ajo e harkut duhet të ngrihen proporcionalisht.Argjinaturat duhet të ngrihen të paktën me 2.0 m.



Në mbështetje të projekt idesë në vitin 2019 Bashkia Fier në Bashkpunim me Ministrinë e Mbrojtjes realizuan ndërhyrjen e pare duke ndërtuar Argjinaturën segmenti Rruga e Klosës deri në Kalimin e rrugës nacionale Levan Vlorë. Ndërhyrja do të

konsistente në ngritjen e argjinaturës në 1.2-1.5m mbi argjinaturën ekzistueses si dhe riparimin e ngritjen e kuotave në të gjithë ura kaluese përgjat segmenti të kësaj argjinature


Në kuadrin e ristrukturimit të mbrojtjes së lumit me variantin e ngritjes së argjinaturave në këtë projekt parashiokojme

RIKONSTRUKSIONI I ARGJINATURËS PËR MBROJTJA NGA PËRMBYTJET E LUMIT VJOSA" ZONA E FERRASIT

Segmenti I Zonës Feraste do të jetë segmenti prej 1448m që përshkuan gjatësinë e shtrirjes ë lufshatit feras





Rikonstrukcioni do të konsistojeë në mbushjen dhe ngritjen e argjinaturave dhe




PHOTO

PHOTO_20220804_0611

www.ingegneringegneri.it
Via S. Antonio 2, 20122 Milano
Tel. 02 76000000





mbushjen e saj me dhe.

Materiali i nert do të merret nga kavat e dheut në zonën përreth dhe Dheu me përzjerje konglone rate do të merret në Fshatin Adë 2km larg nga Argjina tura e Frakullës ku do ti duhet një distance trasporti 2km deri 3.3km dhe 5-6.5 materiali inert zhavori I cili do të merret në Kavën e Peshtanit Breg I cili ka një distance rreth 5km nga argjina tura e frakullës dmth distance 5 dhe 6.5km dhe 8km -8.5km

Gjatësia 1448.45ml elementët e argjinaturës Baza 3.5m m1.5

Per realizimin e punimeve jane parashikuar e kryen punimet te sistemimit si

Prerje sistemim pemesh 10-20cm 20 cope

Rafshim skarapatesh me germim me eskacator 7450 m2

Ne ndertimin e argjinatures jane llogaritur te mbushen me material dheu gjithsej

12980 m3 dhe nështresa cakulli apo zhavor trashesi 15cm mbi argjina tura 6250m2

Ne ndertimin e argjinatures jane parashikuar ngritje urash n ndertim shpatulla urash ndertime rama per hyrje te qytetareve ne banesa ne zonen e banuar .

Dherat per mbushjen e argjinatures jane parashikuar te meren ne kavat prane zonest se ndertimit te argjinatures si Kava e Ades 2kmm ne veri te Zones dhe kava e zhavorit ne Peshtan Bregas 4 km ne Veri

Materiali i nert do të merret nga kavat e dheut në zonën përreth dhe Dheu me përzjerje konglone rate do të merret në Fshatin Adë 2km larg nga Argjina tura e

Frakullës ku do të duhet një distance transporti 2km deri 3.3km dhe 5-6.5 materiali inert zhavori I cili do të meret në Kavën e Peshtanit Breg I cili ka një distance rreth 5km nga argjinatura e frakullës dmth distance 5 dhe 6.5km dhe 8km -8.5km

Gjatësia 1448.45ml elementët e argjinaturës Baya 3.5m m1.5

Per realizimin e punimeve jane parashikuar e kryen punimet te sistemimit si

Prerje bimesh te vogla deri th cm ne sasi 5720m²


Prerje sistemim pemesh 10-20cm 20 ccope

Rafshim skarapatesh me germim me eskacator 7450 m²

Ne ndertimin e argjinatures jane llogaritur te mbushen me material dheu gjithsej 12980 m³ dhe nshtresa cakulli apo zhavor trashesi 15cm mbi argjinature 6250m²

Ne ndertimin e argjinatures jane parashikuar ngritje urash n ndertim shpatulla urash ndertime rama per hyrje te qytetareve ne banesa ne zonen e banuar .

Dherat per mbushjen e argjinatures jane parashikuar te meren ne kavat prane zoness se ndertimit te argjinatures si Kava e Ades 2kmm ne veri te Zones dhe kava e zhavorit ne Peshtan Bregas 4 km ne Veri



Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.

PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONE

Te pergjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re Fier kufizohet ne veri me bashkine Divjake, ne lindje me bashkite Patos dhe Roskovec, ndersa ne jug me bashkine Vlore. Ajo shtrihet ne Ultesiren Perendimore, mes lumenjve Seman dhe Vlore. Pjesa dermuese e bashkise se re shtrihet ne zone fushore te ulet ndersa komunat Cakran dhe Frakull kane territor kodrinor. Kryeqendra e Bashkise eshte qyteti i Fierit.



Popullsia: Sipas Censurit te vitit 2011 ne territorin e bashkise se re banojne 120.655 njerez ndersa ne regjistrin civil rezultojne banore 196.324 njerez. Siperfaqja e bashkise se re eshte 619.9 km². Ne baze te censurit, densiteti i popullise eshte 194.6 banore per kilometer katror ndersa ne baze te regjistrin civil, densiteti eshte 316.70 banore/km². Kjo bashki perbehet nga dhjete njesi administrative, te cilat jane: Fier, Cakran, Mbrostar Ura, Libofshe, Qender, Dermenas, Topoje, Levan, Frakull dhe Portez. Te gjitha njesite administrative jane aktualisht pjese e rrethit te Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nen administrimin e saj nje qytet dhe 85 fshatra.

3.2 Profili i bashkise

Bashkia e re e Fierit perfshin zonat bujqesore me te rendesishme te vendit, si dhe nje pjese te konsiderueshme te industrise qe lidhet me perpunimin e naftes.

Me shume se 55 per qind e popullsisë se bashkisë së re jetojnë në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të bashkisë së re. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i shumëllojshëm nga drithi të zarzavatet, bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj.

Në territorin e bashkisë së re gjenden toka shumë pjellore, të cilat dikur kanë qenë kënetë dhe që sot janë të rrezikuara vazhdimisht nga përmytjet.

Bashkia e re do të ketë një vijë bregdetare të konsiderueshme që shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjose deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjake-Karavasta.

Si një zonë industriale e rëndësishme e kohës së komunizmit, Fieri vuan në veanti nga papunesia e lartë e shkaktuar nga mbyllja e fabrikave, si dhe nga ndotja mjedimore e Jenë pas nga industria tashme e mbyllur. Përveç ndotjes së trashëguar, qyteti rrezikohet edhe nga ndotja që shkaktohet nga industria që ka mbijetuar. Pjesa më e madhe e ndotjes vjen nga industria e naftës dhe rafineritë e vajit ushqimor, të cilat ndosin ajrin sidomos gjatë periudhës së nates.

Bashkia e re ka një vijë bregdetare të konsiderueshme, si dhe pjesë të saj është dhe parku arkeologjik i Apollonisë, krahas objekteve të tjera të trashëgimisë kulturore.

Shfrytëzimi i bregdetit për turizëm është ende në fillimet e veta. Njësitë administrative Topoje dhe Dermenas kanë një vijë bregdetare më të vjetër prej 30 kilometrash, e gjitha shumë e përshtatshme për turizmin familjar. Vlerësohet se rreth 10 mijë vete në vit sakaq zgjedhin këtë vijë bregdetare për pushime verore, kryesisht afatshkurtra.

Sfidat më të cilat do të përballë pushteti vendor pas ndarjes së re

Rehabilitimi i territorit të demtuar nga industria si dhe pastrimi i ujërave identifikohen si dy ndër sfidat kryesore të bashkisë së re, të cilat lidhen ngushtë dhe me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në këtë zonë. Ndëlimi i ndotjes industriale apo të ujërave të lumenjve, veçanërisht Semanit, mund të ndihmojë në zhvillimin e një mjedisi të pastër dhe të përshtatshëm për turizmin.

Zgjerimi i funksioneve të bashkisë ekzistuese të qytetit të Fierit në një territor të gjërë pritet të përbejë një tjetër sfidë, veçanërisht për shkak të nevojave shumë të ndryshme nga qyteti që kanë të 85 fshatrat që përfshihen në bashkinë e re. Në zonat rurale, mirëmbajtja e infrastrukurës së vaditjes dhe kullimit të cilat janë përgjegjësi e pushtetit vendor identifikohen nga komuniteti si shqetësimet kryesore.

Zona e bashkisë së re, përfshirë edhe vete qytetin e Fierit, janë shumë të prekura nga përmytjet e shpeshta, rrjedhimisht shtimi i investimeve në infrastrukturën mbrojtëse nëpër komunat përgjatë lumit Vjose edhe mirëmbajtja e infrastrukurës ekzistuese, pastrimi i shtrateve të lumenjve dhe kontrolli i ndertimeve pa leje përgjatë lumit Gjanice identifikohen ndër sfidat kryesore më të cilat pritet të përballë bashkia e re.

Një ndër problematikat e tjera të rëndësishme për komunitetin e kësaj bashkie të re

është dhe furnizimi me uje te pishem dhe kontrolli i cilesise se tij.


NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE STRATIGRAFIA

1.1. Ndertimi Gjeologjik i Rajonit

Kuadratimi gjeologjik.

Territori ku përfshihet hapja e vendburimit ben pjese ne zonen e ndertimit te autostrades Levan Tepelene, lokalizohet në fillimin jugor të tërthores Shkodër-Pejë (Scutari-Pec) që ndan Dinaridet s.s.nga Helenidet; rajoni ndodhet brenda helenideve, ose sipas autorëve Shqiptarë, brenda Albanideve. (Figg. 1, 2 e 3).

Albanidet bëjnë pjesë në thrust belt Dinaride - Albanide - Helenide, që është formuar gjatë orogjenezës Alpine (Fig.2), dhe që rrjedh nga evolucioni tektonik-fundërrësor i mikropllakës Adriatike që është zhvilluar nga Triasiku deri më sot.



Historia gjeodinamike e Albanideve është e kontrolluar nga evolucioni i Paleotidit. Paleotidi është hapur pas Orojenezës Ercinike (fundi i orogjenezës paleozoike) dhe më vonë rrëshqet drejt jugut poshtë sektorit jugor të gjirit të gjërë të Pangaeas nga Triasiku i mesën në Jurasikun e poshtëm.

Rrëshqitja jugore e krostës paleotide gjatë Triasikut është e shoqëruar nga hapja e Oqeanit të Neotidit; fillon kështu në Triasik një fazë rifting. Në këtë fazë depozitohen argjila, evaporite dhe dolomite me ndërthurje të pasura me sedimentim organik.

Gjatë Jurasikut të poshtëm (Lias) faza shtrirëse ka vazhduar me një sedimentim pelagjik në Baserin qendror të Jonit (depozita të black-shale në Posidon) dhe sedimentimi i platformës

(dolomitet) në Basenet e Sazanit dhe Krujës. Kjo fazë rifting arrin maksimumin e saj gjatë Jurasikut të mesëm me formimin e ofioliteve në Oqeanin Mirdita.

Gjatë Jurasikut të mesëm - të sipërm, pllaka Adriatike ndahet nga platforma Evropiane lindore (formimi i Oqeanit Mirdita) dhe sedimentimi pelagjik instaurohet në 3 mjediset e Basenit Jonian (Çika, Kurveleshi e Berati). Depozitohen kështu dy intervale me sedimentim silicor dhe argjiloz të pasura me material organik. Në zonat ngjitur (Kruja dhe Sazani) vazhdon sedimentimi i platformës karbonatike.

Faza e parë ngjeshëse që përfshin skajin lindor të Pllakës Adriatike fillon gjatë Jurasikut të sipërm dhe vazhdon deri në kretakun e poshtëm duke realizuar rrëshqitjen e ofioliteve të Mirditës dhe depozitim të ashtuquajturit "old flysh" në Basenin ngjitur të Krasta-Cukalit. Balli i thyerjeve lëviz në kohë e në hapësirë drejt perëndimit. Në Basenin e Krujës dhe atë Jonian flishi është më i ri dhe i përket epokës së Oligocenit.

Gjatë Kretakut të poshtëm sedimentimi pelagjik vazhdon në Basenin Jonian. Depozitohen gëlqerorë argjiloz dhe strall që kalojnë në pjesën e sipërme në argjila diatomike të pasura me lëndë organike.

Nga fundi i Eocenit Pllaka Afrikane ndryshon drejtimin e lëvizjes; nga një kinematikë drejt veri-lindjes, duke krijuar një seri strukturash të bashkangjitura të tipit strike-slip të orientuara në përgjithësi në VVP-JJL; ky moment koinçidon me mbylljen e Oqeanit Mirdita dhe përplasjen e Adrias dhe Evropës. Në Basenin e Krasta-Cukalit depozitohet flishi me facies sinorogjenike ndërsa në mjediset e Krujës dhe Sazanit instaurohet një platformë karbonatike me hippuritoide dhe Baseni Jonian mbushet me kalkarenite (mudstone-packstone-grainstone) dhe lente stralli. Këto gëlqerore detritike të thyera përbëjnë rezervuarin e fushave naftëmbajtëse karbonatike ekzistuese në Shqipëri.

Mesozoi, në përgjithësi, është i dominuar nga një sedimentim karbonatik në skaje kontinentale të platformës (Pulia dhe Kruja) dhe të basenit (Jonian dhe Krasta-Cukali).

Oligoceni shënon fundin e sedimentimit karbonatik në të gjitha Albanidet.

Ngritja e zonës Krasta-Cukali drejt lindes, si rezultat i shtypjes, çon në depozitim të flishit të oligocenit në Basenet e Krujës dhe Joniane. Një sekuencë e shpeshtë facies klastike depozitohet në veri në linjën Vlorë-Elbasan si rezultat i rrëshqitjes së lartë që karakterizon basenin e Durrësit (foreland).

Gjatë Miocenit, molasat (deltore drejt lindes dhe turbidite drejt perëndimit) depozitohen në zonat më ekstreme; faza e parë shtypëse që intereson zonat joniane dhe atë të Krujës i përket Miocenit të mesëm dhe çon në strukturimin e këtyre zonave. Impulsi i parë i migrimit të oolit është në lidhje me këtë fazë.

Gjatë Pliocenit, sedimentimi klastik vazhdon në Basenin e foreland. Në fund të Pliocenit një trasgresion (i shkaktuar nga lëvizja e Pllakës Adriatike drejt VVP) intereson të gjithë zonën dhe struktura kalimtare formohen në Basenin e Durrësit. Faza post-pliocenike karakterizon strukturat kryesore në lindje të Basenit të Durrësit.

Në sintezë, në Domainin Jonian diferencimi i facies fillon gjatë Jurasikut të poshtëm. Facies e Delvinës (dolomitet e ndërthurura me argjila bitumozë ose stralle të rara) depozitohet në pjesën qendrore dhe mbulohet më vonë nga argjila bituminoze në Posidonia të Ladinianit, ndërsa në skajet, dolomite masive dhe gëlqerore algale mbizotërojnë, të ndjekur drejt pjesës së sipërme nga gëlqerorë në të Kuq Amonitik të Ladinianit.

Nga Jurasiku i mesëm e më tej, kushtet e sedimentimit të basenit dominojnë brenda Domainit Jonian me depozitim të mudstone dhe strallit.

Në Basenin e Krujës dhe Sazanit sedimentimi i platformës ngelet stabil nga Triasiku i sipërm në Eocen.


Baseni i Durrësit zhvillohet nga Oligoceni deri më sot; ai karakterizohet si një basen foreland i gjendur në ballin e thrust-belt në përparim. Depoqendra e tij ndodhet gjatë linjës Ardenicë-Divjakë. Të dhënat demostrojnë një gjeometri të përgjithshme mbushëse të basenit me facies progreduese nga lindja drejt perëndimit.

Evolucioni tektonik

Albanidet përbëjnë pjesën qendrore të harkut Helenide-Dinaride të zinxhirit Alpin; mbi bazën e evolucionit tektonik dhe stratigrafik ata ndahen në albanide të brendshme dhe të jashtme. (Prenjasi E., 1995). Albanidet veriore dhe jugore ndahen nga thyerja tërthore Shkodër-Pejë, ndërsa Albanidet e brendshme përbëhen nga zonat e Mirditës dhe Korabit në jug dhe nga Gashi në veri (Fig. 4).

Albanidet e jashtëm përfshijnë mjediset e mëposhtëm tektonike-sedimentare; Krasta-Cukali, Kruja, Joni, Sazani, Durrësi

Rajoni i Fier- Mallakaster- Tepelene bie në zonën Joniane (Jonian). Një zonë e tillë përfshin disa sektorë të karakterizuar nga sinklinale dhe antiklinale që nga lindja drejt perëndimit janë : sinklinalja e Përmetit, antiklinalja e Beratit, sinklinalja e Memaliajt, antiklinalja e Kurveleshit, sinklinalja e Shushicës dhe antiklinalja e Çikës (Fig. 5); ato kanë një trend të përgjithshëm VP-JL. Këto struktura kanë një asimetri drejt perëndimit dhe janë të komplikuar nga mbihipje në shpatë perëndimorë (Fig. 5). Masa e transportit tektonik drejt perëndimit të mbihipjeve qoftë të zonës të Krujës qoftë të zonës Joniane stimohet rreth 15 dhe 50 km. (Xhufi & Canaj, 1999).



Janë të pranishme edhe thyerje trasversale ndaj sistemit kryesor.

Thyerjet e tipit back-thrust gjenden në shpate lindore të strukturave antiklinale, ndërsa në shpatet perëndimore ndonjëherë strukturat janë të gërryera deri në depozitat Triasike-Jurasike.

Struktura litologjike lokale

Metodologjia e rilevimit u bazua në kryerjen e numrit më të madh të mundshëm të dallimeve gjeolitologjike mbi sedimentimet detare që përbëjnë substraktin (terreni parësor), duke studiuar edhe organizimin strukturor lokal, dhe hartografimin në detaj të shtresave të mbulimit, duke dalluar përbërjen litologjike mbizotëruese.

Sedimentimet detare turbidite (terrenet parësorë) janë hartografuar duke adoptuar metodën depozituese në lidhje me turbiditetet të Mutti dhe Ricci Lucchi (Sedimentologjia - parte III - , F. Ricci Lucchi, 1980) me qëllim dallimin e njësive të ndryshme litostratigrafike; në veçanti është mbajtur në konsideratë raportin shkëmb ranor/pelitik dhe trashësia e shtresave. Rilevimi direkt i njësive detare dhe identifikimi i elementeve strukturorë (thyerje, joints, etc.) u pengua nga urbanizimi dhe nga aktivitetet njerëzore në përgjithësi; prandaj, sidomos në zonat më në jug, përcaktimi i njësive litostratigrafike dhe i elementeve tektonike është deduktuar nga elemente morfologjike.

Oservacionet geomorfologjike kanë ndihmuar rilevimin gjeologjik, në mënyrë të veçantë në identifikimin e formave me origjinë nga influenca e/o kontrolli i litologjisë mbi geomorfologjinë.

Karakterit i depozitimeve është ai sedimentar ku shkurtimisht do të flasim për stratigrafinë dhe kushtet e formimit sedimentar të depozitimeve që përfshihen në zonën tonë.

Më poshtë do të bëjmë përshkrimin stratigrafik të depozitimeve duke i përshkruar, nga ato më të vjetrat, drejt atyre më të reja.

Depozitimet me te vjetra qe takohen ne kete rajon do te jene Depozitimet Karbonatike te Kretakut te siperm te cilat i kapim ne majat me te larta te dhe pikerisht ne Tepelene dhe ne prerrjen e Kremenares Dames, duke shkuar me tej ato zbresin ne depozitime me te reja po Karbonatike te Moshes Eocen Paleocen i Poshtem dhe i mesem te cilat takohen ne Aranitas, Vazhdojne me tej ne depozitimet Floshore te Neogjenit Kodrat e Cakranit dhe deri ne Kurozoren e Peshtanit te cilat shuhet ne kodrat e mbuetit e deri ne Fier.. Me zhytjen e depozitimeve Neogjenike ne menyre trazgresive mbivendosen depozitimet e mevoneshme ato kuaternare te fushes se Cakranit.

Me poshte po japim nje rezume te qarte te ketyre depozitimeve.

KARBONATET E CRETAKUT TË SIPËRM (Cr₂)

Kanë shtrirje të gjërë në zonat kodrinore malore

Përfaqsohen nga gëlqerorë, me ngjyrë gri të hapru në disa raste edhe të bardhë në ngjyrë të qumështit.

